

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	2
II. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE: ROLET DHE MANDATI.....	2
Kombet e Bashkuara (KB).....	2
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).....	3
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja).....	3
Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ-të).....	4
Këshillat e Vendvotimit (KV-të).....	4
III. KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE.....	4
Parimet.....	5
Funksionet dhe Detyrat.....	5
Përgjegjësitë.....	6
Marëdhëniet me Zyrën e Terrenit të OSBE-së.....	7
Bazat e Menagjimit të Zgjedhjeve.....	7
Rekrutimi i Këshillave të Vendvotimit (KV-ve).....	8
IV. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PROCESIT TË ZGJEDHJEVE.....	8
Sistemi i Zgjedhjeve.....	8
Fletëvotimi.....	9
Vërtetimi i Partive Politike, Koalicioneve, Iniciativeve Qytetare Kandidatëve të Pavarur.....	9
Regjistrimi i Kandidatëve.....	10
Kodi i Sjelljes.....	11
Publikimi i Financave të Fushatës dhe Kufizimet e Shpenzimeve.....	12
Shqyrtimi Publik i Listës së Votuesve, Periudha e Konfirmimit, Shtimit dhe Sfidave.....	12
Mediat.....	13
Informimi i Votuesve.....	14
Vëzhguesit.....	14
Nën-Komisioni i Zgjedhjeve për Parashtrësia dhe Ankesa.....	15
Teknologjia e Informacionit.....	17
Zgjidhja e Konfliktit.....	17
V. SHKURTESAT.....	18

I. HYRJE

Urime për emërimin e juaj si anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ). Ju jeni një pjesë integrale e ekipit të menaxhimit të zgjedhjeve për zgjedhjet e ardhshme komunale në Kosovë. Anëtarët e KKZ-së janë emëruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja) dhe mbikëqyren nga ata dhe nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Asnjë person, grup ose organizatë tjetër nuk mund t'u japë udhëzime KKZ-ve rreth asaj se si t'i kryejnë detyrat e tyre.

Më 28 Tetor të vitit 2000 votuesit do të zgjedhin kuvendet komunale në 30 komuna për mandat dyvjeçar. Kuvendet komunale do të jenë përgjegjëse për shërbime të llojllojshme lokale, duke e përfshirë këtu arsimin, shëndetësinë, shërbimet shoqërore, amvisërinë, planifikimin, etj. Këto përgjegjësi dhe përbërja e kuvendeve janë të përcaktuara në Rregulloren mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45).

Ky doracak për anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) do të ju njoftojë me rolin dhe përgjegjësitë e juaja të reja si administratorë të zgjedhjeve. Doracak, së bashku me sesionin e parë të trajnimit, do të përshkruajë se si anëtarët e KKZ-së do të përshtaten në administrimin e përgjithshëm të zgjedhjeve për zgjedhjet komunale. Sesioni i dytë i trajnimit do të sigurojë të dhëna të hollësishme mbi procedurat e votimit dhe të numërimit.

Komisioni i zgjedhjeve është një organ profesional që punon në mënyrë neutrale, jo partiake. Anëtarët që punojnë në Komision ndihmojnë në rënjosjen e besimit në procesin e zgjedhjeve duke i bërë vendimet dhe veprimet e tyre transparente për votuesit. Votuesit duhet të kenë qasje të lehtë në informacionin që ka të bëjë me procesin e zgjedhjeve dhe vendimet e juaja.

Anëtarët e KKZ-ve punojnë së bashku me OSBE-në dhe KQZ-në për t'u shërbyer votuesve të Kosovës që të sigurojnë zgjedhje të lira dhe të drejta e në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Veprimet e juaja në lidhje me këtë do të ndihmojnë për të bërë rezultatet e pranueshme për të gjithë votuesit.

II. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE: ROLET DHE MANDATI

Kombet e Bashkuara (KB-të)

Këshilli i Sigurimit i ka dhënë autoritet Misionit të Përkohshëm Administrativ të KB-së në Kosovë (UNMIK-ut) mbi territorin dhe njerëzit e Kosovës, duke e përfshirë të gjithë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv si dhe administrimin e organeve të drejtësisë. Ndër detyrat e tij kyqe, UNMIK-u është duke e bërë:

- kryerjen e funksioneve themelore të administratës civile;
- lehtësimin e procesit politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës;
- përkrahjen e rindërtimit të infrastrukturës kyqe dhe ndihmave humanitare dhe atyre në rast fatkeqësie;
- ruajtjen e rendit dhe ligjit civil;
- promovimin e të drejtave të njeriut; dhe
- sigurimin e kthyerjes së sigurtë dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë.

UNMIK-u është unik në kompleksitetin dhe gjithëpërfshirjen e tij. Katër organizata dhe agjensi ndërkombëtare janë duke punuar së bashku në një operacion nën udhëheqjen e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Dr. Bernard Kouchner. Katër sektorë janë të përfshirë për të bërë implementimin e aspekteve civile të riaftësimin dhe reformimit të Kosovës. Këta sektorë, gjithashtu të njohur si “katër shtyllat” janë:

- Shtylla 1 Ndihma Humanitare, nën UNHCR-in
- Shtylla 2 Administrimi Civil, nën KB-në
- Shtylla 3 Demokratizimi dhe Ndërtimi i Institucioneve, i udhëhequr nga OSBE-ja
- Shtylla 4 Rindërtimi Ekonomik, drejtuar nga UE-ja

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMIK) është duke e marrë rolin kryesor në qështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. OMIK-u është përgjegjës për:

- organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve
- demokratizimin dhe qeverisjen
- ndërtimin e kapaciteteve të kuadrove
- qështjet e mediave
- monitorimin e të drejtave të njeriut

OMIK-u është prezent në pesë Qendra Rajonale dhe Zyre të Terenit, të cilat do t’u shërbejnë komunave të Kosovës. Ai ka më shumë se 700 të punësuar ndërkombëtarë dhe 1500 të vendit. Ambasadori Daan Everts është kryesues i Misionit dhe ai gjithashtu ka qenë i emëruar si Zëvendës i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për Ndërtimin e Institucioneve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është themeluar nga Rregullorja e UNMIK-ut (2000/21). KQZ-ja përbëhet prej nëntë Kosovarëve dhe tre anëtarëve ndërkombëtarë, të emëruar për mandat dy vjeçar. Është organi kryesor rregullues i cili mbikëqyrë zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve. Funkcionet e KQZ-së janë:

- të jetë përgjegjës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë; dhe
- të përgatisë dhe lëshojë rregullat e zgjedhjeve sipas sistemit të aprovuar të zgjedhjeve dhe administrimit të procesit të zgjedhjeve .

KQZ-ja emëron anëtarët e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, duke e përfshirë Kryetarin dhe Sekretarin, për mandatin dy vjeçar.

Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ)

Në secilën komunë një Zyrtar i Zgjedhjeve i OSBE-së është përgjegjës për aktivitetet e zgjedhjeve të OMIK-ut në zonën e tij apo saj. Zyrtari i Zgjedhjeve ka siguruar përkrahje logjistike në zgjedhjen e anëtarëve të KKZ-ve të cilët mandej u emëruan nga KQZ-ja për mandat dy vjeçar. Çdo KKZ përbëhet nga tre deri në shtatë anëtarë varësisht nga popullsia dhe madhësia gjeografike e komunës. KQZ-ja gjithashtu ka bërë përpjekje që të sigurojë se grupet e minoriteteve janë të përfaqësuara drejtë në tërë Kosovën.

Këshillat e Vendvotimit (KV)

OSBE-ja në konsultim me KKZ-në dhe Zyrtarin e Zgjedhjeve në secilën komunë, emëron Këshillat e Vendvotimit. KV-ja përbëhet nga Kryesuesi dhe katër anëtarë të cilët do të operojnë në vendvotim. Detyrat e tyre janë që të zhvillojnë votimin në vendvotimet e rregullta dhe ato në mungesë, si dhe të drejtojnë numërimin e votave në vendvotimet e rregullta. Të dhënat e tjera të hollësishme të detyra të tyre do të përfshihen në doracakun e të trajnimit për KV-të.

III. KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE

Më 18 Maj të vitit 2000, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja) miratoi Rregullën e Zgjedhjeve 2000/4, e cila krijoi Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ-të). Rregulla e Zgjedhjeve themeloi kriteret për emërimin e anëtarëve, duke i përfshirë kërkesat që:

- anëtarët duhet të jenë votues të regjistruar për zgjedhjet komunale në komunën ku ai ose ajo shërben;
- anëtarët duhet të kenë post të lartë profesional me eksperiencë dhe njohuri administrative ose elektorale;
- të jenë të përfaqësuara drejt grupet minoritare; dhe
- të zbatohen ndalesat e poshtëshënuara:
 - a) synimi ose mbajtja e postit të zgjedhur publik
 - b) mbajtja e postit të caktuar publik
 - c) qëndrimi si kandidat për zgjedhje
 - d) të qenët në pozitë udhëheqëse të iniciativës qytetare
 - e) të qenët anëtar i bordit të partisë politike ose koalicionit
 - f) nëse zbulohet të ketë shkelur seriozisht një Rregull të Zgjedhjeve, Rregullore, Direktivë Administrative të Procedurës që ka të bëjë me procesin e zgjedhjeve.

Procesi i emërimit dhe procedurat e largimit janë të përfshira në Rregullën e Zgjedhjeve (shih pakon informative).

Çdo Komision përfshin Presidentin dhe Sekretarin ashtu siq janë caktuar nga KQZ-ja. Mandati për Komisarët është dy vjeçar.

Parimet

Anëtarët e KKZ-së ndihmojnë në administrimin e zgjedhjeve, nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e OSBE-së dhe KQZ-së. KKZ-të ndihmojnë për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e zhvillimit të zgjedhjeve nën juridiksionin e tyre.

Efikasiteti i zhvillimit të zgjedhjeve përfshin:

- përmbyshjen e afateve të zgjedhjeve
- kryerjen e detyrave dhe raportimin ashtu siq kërkohet
- të sigurohet që i gjithë informacioni i raportuar është i saktë
- nxjerrjen e vendimeve sipas nevojës
- të punohet ngushtë me Zyrtarët e Zgjedhjeve
- ndarjen e përgjegjësisë e detyrave në mes të anëtarëve të Komisionit (p.sh. njëri të jetë përgjegjës për rolin e informacionit, e njëri për rolin e logjistikës, etj.)
- rekomandimin me kohë të emrave për emërimet pranë KV-ve.

Legjitimiteti i zhvillimit të zgjedhjeve përfshin:

- implementimin e Rregullave të Zgjedhjeve dhe Procedurave Administrative
- transparencën në punën e Komisionit
- nxjerrjen e vendimeve nga shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve
- frenimin nga nxjerrja e vendimeve në rastet ku ka konfliktin të interesit
- sigurimin e trajtimit të barabartë të të gjithë votuesve.

Funksionet dhe Detyrat

Funksioni i Komisionit për të ndihmuar në administrimin e zgjedhjeve do të ndryshojë varësisht prej fazës së organizimit dhe planifikimit të zgjedhjeve. Në përgjithësi, këto detyra do të përfshijnë:

- komunikimin e rregullt me Zyrtarin e Zgjedhjeve
- përcjelljen e raporteve të shkurtëra dhe/ose trajnimeve të mbajtura nga OSBE
- mbajtjen e mbledhjeve në orar të rregullt
- njohjen e Rregullave të Zgjedhjeve dhe Procedurave Administrative
- sigurimin e informacionit për entitetet politike të komunës
- mbajten e kontaktit me grupet e vëzhguesve
- mbajtjen e regjistrave dhe shënimeve të takimeve dhe punës suaj
- rekomandimin e personelit për Këshillat e Vendvotimeve
- të ndihmohet në trajnimin dhe motivimin e Këshillave të Vendvotimit
- të ndihmohen iniciativat për edukimin e votuesve
- dorëzimin dhe përcjelljen e materialeve sipas nevojës.

Në secilën fazë ndihma e Komisionit është e koordinuar me Zyrtarin e Zgjedhjeve të OSBE-së dhe nëpërmjet tij ose saj, me KQZ-në. Gjatë përgatitjeve për zgjedhje mund të kërkohet edhe ndonjë ndihmë tjetër nëpërmjet këtyre kanaleve.

Përgjegjësitë

Rregulla e Zgjedhjeve 2000/4 përcakton përgjegjësitë e veqanta për KKZ-të në Seksionin 4.30 siq vijon:

- a) Anëtarët e KKZ-ve do të përcjellin të gjitha takimet dhe mbledhjet të prezentuara dhe të sponsoruara nga OSBE-ja.
Anëtarët e Komisionit duhet të përgatiten për këto mbledhje dhe trajnime kështu që të jenë të informuar dhe të përfshirë në të gjitha përgatitjet e zgjedhjeve. Kjo mund të përfshijë mbledhjet me personelin e sigurimit, pjesëmarrësit politik, mbikëqyrësit dhe vëzhguesit.
- b) KKZ-të do të mbajnë shënime praktike
Një aspekt i rëndësishëm i zgjedhjeve demokratike është transparenca në të gjitha fazat dhe përgatitjen e zgjedhjeve. Shënimet duhet të jenë të qarta, të reja dhe të hapura ndaj atyre të cekura në Rregull, p.sh. KQZ-në dhe përfaqësuesit e saj të autorizuar, mbikëqyrësit ndërkombëtar, vëzhguesit dhe personelin e UNMIK-ut. Shënimet do të përfshijnë rendin e ditës së mbledhjeve, procesverbalet me vendime, raportet etj. KKZ-ja gjithashtu do të ketë qasje në çdo shënim të Zyrës së Terenit të cilat nevojiten për kryerjen e detyrave të tyre. Do të jetë e rëndësishme për të gjithë anëtarët e Komisionit që të ndajnë informacionin me njëri tjetrin.
- c) Nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e OSBE-së dhe KQZ-së, KV-të do të ndihmojnë në administrimin e zgjedhjeve duke përfshirë por jo të kufizuara në:
 1. njoftimin e votuesve mbi informacionin e nevojshëm për administrimin e zgjedhjeve;
Komisioni do të ndihmojë OSBE-në në shpërndarjen e informacionit të votuesve duke i përfshirë orët e votimit, lokacionet e vendeve të votimit dhe qfarëdo informacioni të veçantë që ka të bëjë me komunën në pyetje. Anëtarët e Komisionit duhet të jenë të gatshëm që të ndihmojnë në përgjegjësitë në pyetjet të parashtruara nga votuesit, OJQ-të dhe grupet tjera.
 2. në mënyrë neutrale dhe të paanshme t'iu sigurohet informacion partive politike, iniciativave qytetare, koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur rreth të drejtave dhe obligimeve të tyre;
Komisioni do të ndihmojë OSBE-në në sigurimin e Rregullave të Zgjedhjeve dhe informacionit përkatës për organizatat politike dhe kandidatët. Anëtarët e Komisionit gjithashtu do të jenë të gatshëm që t'u përgjigjen qfarëdo pyetjeve të parashtruara nga këto grupe. Është me rëndësi që Komisioni të jetë i informuar mirë dhe i azhuruar me leximin e informatave nga KQZ-ja dhe OSBE-ja (p.sh. komunikatat e lajmeve, udhëzimet administrative etj.)
 3. të ndihmojë në trajnimin dhe emërimet e Këshillave të Vendotimit;
Komisioni do të respektojë kriteret për personelin e votimit kur të rekomandohen emrat për Këshillat e Vendvotimit. Ata do të ndihmojnë trajnerët e OSBE-së në organizimin e trajnimit.

4. të ndihmojnë në rregullimin teknik në Vendvotime dhe ndonjë përgatitje tjetër teknike për zgjedhje; dhe
Komisioni do të ndihmojë sipas nevojës në rregullimet e lokalit të vendvotimeve, depozitimin dhe transportimin e materialeve si dhe bartjen e fletëvotimeve.
5. të sigurojë zhvillimin e drejtë të votimit, numërimin dhe përpilimin e rezultateve të zgjedhjeve.
Komisioni do të marrë hollësitë e këtyre proceseve në sesionin e dytë të trajnimit.

Mardhënjet me Zyrën e Terenit të OSBE-së

Për orgazimin e suksesshëm të zgjedhjeve është e nevojshme një marëdhënie e ngushtë e punës në mes të Komisionit dhe Zyrës së Terenit. Zyrtari i Zgjedhjeve në Zyrën e Terenit të OSBE-së është përfaqësues i OSBE-së i cili do të punojë me komisionin për përgatitjen dhe udhëheqjen e zgjedhjeve. Megjithatë, masat e sigurisë dhe të logjistikës do të përfshijnë zyrtarë të tjerë në Zyrën e Terenit dhe lidhjet e ngushta do të jenë të dobishme për të gjithë ata që janë të përfshirë në zgjedhje.

Informatat dhe direktivat i dërgohen Zyrtarit të Lartë të Zgjedhjeve në Qendrën Rajonale, i cili pastaj i informon Zyrtarët e Zgjedhjeve në Zyret e Terenit. Kjo është lidhja e KKZ-ve me informatat esenciale. Plani duhet të jetë i përgatitur ashtu që të sigurojë të merrni këtë informata me kohë. Krijoni një lidhje komunikimi me Zyrtarin e Zgjedhjeve që të siguroheni se informata është në dispozicion për Komisionin.

Anëtarët e komisionit mund të pyeten nga mediat për komente dhe informata. Reagimi dhe qasja gjithashtu duhet të koordinohen me Zyrën e Terenit. Është me rëndësi që të mos ketë mosëpërputhje të të dhënave nga burime të ndryshme. Kryetari i Komisionit do të marrë rolin e udhëheqësit në lidhje me kërkesat e mediave. Është e nevojshme mbajtja e mardhënieve të mira me mediat meqenëse informimi i publikut varet nga ato.

Zëdhënësi i Misionit flet në emër të Kryesuesit të Misionit. Megjithatë, KKZ-ja mund të flasë konkretisht rreth lëmisë së saj të përgjegjësisë, duke paraqitur pikëpamje të bazuara në fakte. Mos ofroni mendime për politikën e Misionit, mos spekuloni (p.sh. pyetjet “çka nëse”), dhe mos i komentoni thashethemet. Në përgjithësi, parimet e rekomanduara nga OSBE-ja duhet të jenë shoqërore, të hapura dhe të bazuara në fakte. Gjithmonë keni ndër mend se KKZ-ja është organ i pavarur dhe i paanshëm dhe se duhet të ruhet integriteti i saj.

Bazat e Menaxhimit të Zgjedhjeve

Planifikimi dhe menaxhimi i zgjedhjeve përfshinë koordinimin e të gjithë atyre që janë përfshirë në të gjitha organizatat dhe komunat të ndryshme. Që të arrihet kjo, është përgatitur kalendari i datave kritike të zgjedhjeve ashtu që Drejtori i Zgjedhjeve mund të mbajë ngjarjet sipas programit. Kjo do të thotë se të gjitha ngjarjet janë të ndieshme në kohë dhe kërkojnë veprim deri në datën e përcaktuar.

Anëtarët e Komisionit duhet të kenë këtë në mend kur të kërkohet nga ata të kryejnë ndonjë detyrë të veçantë ose të raportojnë informata specifike. Nëpërmjet bashkëpunimit me Komisionet, Zyret e Terenit, Qendrat Rajonale dhe personelin e Selisë, detyrat e Zgjedhjeve do të arrijnë kulmin në një Ditë të suksesshme të Zgjedhjeve.

Rekrutimi i Këshillave të Vendvotimeve (KV)

Punëtorët e Këshillit të Vendvotimit janë personalitetet publike të Komisionit, OSBE-së dhe KB-së në ditën e votimit. KV-ja është përgjegjëse për integritetin, efikasitetin dhe sigurinë e procesit të votimit dhe numërimit në vendvotime. Ata duhet të rrënjosin besimin tek votuesit se procesi është i lirë dhe i drejtë. Për këtë arsye, zgjedhja e personelit është shumë me rëndësi.

OSBE-ja do të emërojë anëtarët e KV-ve pas konsultimit me KKZ-në përkatëse. Secila KV do të përbëhet nga katër anëtarë dhe kryesuesi. Këshilli gjithashtu do të reflektojë deri në një masë të mundshme bashkësitë e ndryshme të përfaqësuara në një komunë të veçantë.

Me rastin e rekomandimit të personave anëtarësim në Këshill, KKZ-ja duhet të ketë në konsiderim qështjet që vijojnë:

- Personeli i zgjedhjeve duhet të jetë i paanshëm dhe neutral në kryerjen e detyrave të tyre.
- Anëtarët duhet të jenë të aftë përfundojnë sesionin e trajnimit dhe të ndjekin udhëzimet që u janë dhënë atyre.
- Secili anëtar duhet të jetë i regjistruar për të votuar në zgjedhje.
- Caktimi për personel të vendvotimit është i ndaluar nëse personi:
 - a) ka qenë i sanksionuar për shkelje serioze të Rregullave të Zgjedhjeve, ose Rregulloreve në fuqi, Procedurave Administrative dhe Direktivave;
 - b) mban post të caktuar publik ose synon post të zgjedhur zyrtar
 - c) është në pozitë udhëheqëse të partisë politike, iniciativës qytetare ose koalicionit
 - d) nuk ka zotësi juridike që të kandidohet për post
 - e) tregon mungesë të paanshmërisë të domosdoshme për të qenë anëtar i Këshillit të vendvotimit.

KKZ-ja do të duhet të ketë në konsiderim aplikacionet për postet e KV-së në mënyrë të paanshme. Rekomandimet që rezultojnë do të jenë pjesë e rëndësishme për të siguruar që zgjedhjet të jenë të pranuar nga të gjithë ata që janë të përfshirë.

IV. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PROCESIT TË ZGJEDHJEVE

SISTEMI I ZGJEDHJEVE

Kuvendet e komunave që do të zgjedhen më 28 Tetor 2000 do të caktohen me anë të sistemit proporcional i zgjedhjeve me lista të hapura me shumë kandidatë. Zgjedhja e këtij sistemi të zgjedhjeve ka për qëllim që të rrisë përgjegjësinë e votuesit duke i dhënë rast atij që t'i zgjedhë kandidatët.

Votuesi do të ketë mundësinë që të votojë qoftë direkt për parti, koalicion, iniciativë qytetare dhe kandidatë të pavarur ose, nëse dëshiron, për një kandidat të pavarur nga lista e partisë, koalicionit ose iniciativës qytetare.

Ndarja e vendeve në mes të kandidatëve nga e njëjta listë do të bëhet së pari në mes të kandidatëve në listë të cilët individualisht kanë marrë vota valide, këto vende të dhëna me radhë nga numri më i madh drejtë numrit më të vogël të votave. Nëse ka ende vende për të iu ndarë listës dhe kandidatët që mbesin janë ata që nuk kanë marrë ndojë votë valide, atëherë shpërndarja e vendeve në mes të kandidatëve të mbetur do të bëhet në përputhje me radhën e tyre në listë.

FLETËVOTIMI

Fletëvotimi do të jetë listë e hapur me udhëzime të duhura deri në tri gjuhë. Në të janë të shënuara të gjitha partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare, dhe kandidatët e pavarur të certifikuar që të paraqiten në zgjedhje në komunë. Emrat janë të shtypur saktësisht në të njëjtën rradhitje ashtu si janë nxjerrë gjatë heqjes së shortit për fletëvotim.

Fletëvotimi gjithashtu përmban një rubrikë ku votuesi mund të shkruajë numrin e një kandidati të preferuar nga entiteti politik që ai/ajo e ka zgjedhur. Fletëvotimi shoqërohet me listën e emrave të kandidatëve për secilin entitet politik që kandidohet në komunë. Kjo listë i prezanton kandidatët me radhë të parashtruar nga entitetet e tyre politike. Ajo do të ekspozohet brenda në kabinën e votimit.

Në mënyrë që të përcaktojë rradhitjen e entiteteve politike dhe kandidatëve të pavarur në fletëvotim, KQZ-ja dhe OSBE-ja i kanë kryer dy heqje të shortit. E para e përcaktoi numrin duke filluar nga numri 11 për secilën parti politike, koalicion dhe iniciativë qytetare. Heqja e dytë e shortit i përcaktoi secilit kandidat të pavarur një numër më të madh se ai i përdorur për partitë politike, koalicionet dhe iniciativat qytetare. Numri i secilit entitet politik të vërtetuar është unik dhe vlenë për tërë Kosovën

Shërbimi i Informimit Publik do të lëshojë disa materiale informative për fushatën dhe për periudhën para zgjedhjeve. Kështu ju do të jeni në pozitë që t'i pëgjigjeni më saktë pyetjeve të elektoratit rreth mënyrës së shenjimit të fletëvotimit.

VËRTETIMI I PARTIVE POLITIKE, KOALICIONEVE, INICIATIVAVE QYTETARE DHE KADIDATËVE TË PAVARUR

Qëllimi i Rregullës së zgjedhjeve të KQZ-së 2000/3 “Vërtetimi i Partive Politike, Koalicioneve, Kandidatëve të Pavarur dhe Iniciativave Qytetare” është të vërtetojë zotësinë juridike të entiteteve politike në mënyrë që të kenë qasje në fletëvotim në zgjedhjet komunale.

Entitetet politike kanë parashtruar kërkesën për vërtetim në secilën komunë në të cilën ato kanë zgjedhë që të kandidohen. Secila parti politike, koalicion, iniciativë qytetare dhe kandidat i pavarur i vërtetuar e dorëzoi listën me më së paku 100 nënshkrime të votuesve me zotësi juridike për komunë në të cilën partia politike ose koalicioni janë vërtetuar. Të gjitha

nënshkrimet në listë duhet të jenë të personave të cilët kanë zotësi juridike për të votuar në atë komunë.

Para se të parashtrijnë kërkesën për vërtetim, partia politike, koalicioni, iniciativa qytetare ose kandidati i pavarur së pari duhet të parashtrijnë kërkesë që të regjistrohen me anë të parashtrimit të dokumenteve Njesisë për Regjistrimin Civil të Administratës Civile të Kombeve të Bashkuara.

Aplikacioni për regjistrim kërkon:

- 1) Së paku 100 nënshkrime të përkrahjes nga personat me të drejtë juridike për të votuar në atë komunë. Këto nënshkrime të përkrahjes mund të jenë të njëjtat ato që janë mbledhur për regjistrimin e entitetit politik.
- 2) Deklaratën e sjelljes të nënshkruar nga Kryetari ose përfaqësuesi i autorizuar i entitetit politik se ai entitet dhe kandidatët e tij do t'i përmbahen Rregullave të zgjedhjeve dhe Rregulloreve, Direktivave Administrative dhe Procedurave që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve
- 3) Pagesën për vërtetim në shumë prej 100 DM për secilën komunë në të cilën entiteti politik parashtron kërkesën për vërtetim. Pagesa do të kthehet nëse fitohet së paku një mandat në komunë ose nëse aplikacioni refuzohet.
- 4) Komunën në të cilën entiteti politik pretendon të kandidohet.
- 5) Emrin e partisë politike, koalicionit ose iniciativës qytetare siç paraqitet në fletëvotim.

Deri në fund të periudhës së vërtetimit, KQZ-ja ka vërtetuar 19 parti politike, 2 koalicione, 3 iniciativa qytetare dhe 15 kandidatë të pavarur.

KQZ-ja ka vendosur këto rregulla që të sigurojë që zgjedhjet në Kosovë të jenë të lira, të drejta dhe demokratike. Kjo kërkon nga të gjithë pjesëmarrësit që t'u përmbahen atyre dhe të lejojnë funksionimin e rregullt të përgatitjeve të zgjedhjeve.

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Rregulla e zgjedhjeve 2000/9 përcakton se partitë politike, iniciativat qytetare ose koalicionet që janë vërtetuar duhet të parashtrijnë listën e kandidatëve pranë KQZ-së për secilën komunë në të cilën partia politike, iniciativa qytetare ose koalicioni ka ndër mend të marrë pjesë. Partitë, koalicionet dhe iniciativat qytetare u lejuan që të parashtrijnë aq kandidatë sa edhe janë vende në kuvendet komunale dhe dhjetë për qind (10%) më tepër. Kandidati duhet të jetë votues i regjistruar në komunë në të cilën kandidati kandidohet për post dhe mund të paraqitet vetëm në një listë të kandidatëve. Kandidati nuk guxon të jetë anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, Trupave Mrojtëse të Kosovës, Forcave Policore të Kosovës, ose të mbajë post të caktuar publik.

Divisioni i Teknologjisë së Informatave (TI) i ka kontrolluar të gjithë 5,500 kandidatët për poste komunale ndaj Listës së Përkohshme të Votuesve që të vërtetojë zotësinë e tyre juridike për tu kandiduar.

KODI I SJELLJES

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxori Rregullën e zgjedhjeve 2000/1, “ Kodi i Sjelljes për Kandidatë, Koalicionet, Iniciativa Qytetare, Parti Politike, Kandidatë të Pavarur dhe Përkrahësit e tyre” me qëllim të promovimit të kushteve në mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe transparente si dhe të një klime të tolerancës demokratike në të cilën aktiviteti politik mund të zhvillohet gjatë periudhës së zgjedhjeve. Kjo kërkon nga entitetet politike (si dhe nga përkrahësit e tyre) t’u përmbahen Rregullave të Zgjedhjeve si dhe të garantojnë proces demokratik të zgjedhjeve. Kodi përshkruan të drejtën e entiteteve politike si dhe veprimet e ndaluara gjatë fushatës dhe para votimit.

Partitë politike, koalicionet, kandidatët, iniciativat qytetare dhe përkrahësit e tyre duhet të njoftojnë Policinë Civile Ndërkombëtare (CIVPOL) së paku katër ditë para se të mbajnë mbledhje/tubime të mëdha publike siç janë tubimet e fushatës ashtu që ato të mos mbahen në të njëjtën kohë dhe vend kështu që të mund të sigurohet siguria e publikut. Ata kanë të drejtë që të shtypin dhe të shpërndajnë posterë dhe material tjetër që kanë të bëjë me fushatën e zgjedhjeve.

Shkelja e Kodit, si edhe shkelja e të gjitha rregullave tjera të zgjedhjeve, mund t’i paraqitet NKZPA-së. KQZ-ja miratoi amandamentin i cili e bën të qartë se kërcënimet dhe përdorimi i dhunës nga partitë politike, koalicionet, kandidatët, iniciativat qytetare dhe përkrahësit e tyre është rreptësisht e ndaluar gjatë procesit të zgjedhjeve. NKZPA-ja gjithashtu mund të marrë vendime mbi shkeljet e kodit me vetiniciativë, p.sh. pa qenë e parashtruar ankesa.

ANËTARËT E KKZ-së

Në komunën tuaj, ju do të keni mundësi që të ndiqni aktivitetet e fushatës së kandidatëve dhe të jeni të informuar nëse ata i përmbahen Kodit. Nga ju kërkohet që të parashtroni ankesë tek NKZPA-ja sa herë që entitetet politike dhe kandidatët e shkelin një rregull të zgjedhjeve duke përfshirë por jo duke u kufizuar në këto që vijojnë:

- Kërkojnë mito ose kërcënojnë votuesit në mënyrë që të fitojnë përkrahjen e tyre dhe të mos lejojnë që ata të votojnë për kundërshtarët politik.
- Nxisin njerëzit që të votojnë dy herë.
- Mbajnë ose ekspozojnë armë në mbledhje politike
- Përdorin gjuhën që nxit urrejtje
- Përdorin fotografi ose simbole të ndonjë të akuzuari nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë në Hagë

Si organ administrativ i zgjedhjeve, ju duhet t’i informoni partitë politike ose kandidatët për të drejtat dhe ndalesat e tyre siç janë përcaktuar në Kodin e Sjelljes së KQZ-së, t’i inkurajoni ata që të veprojnë në përputhje me rregullat e fushatës si dhe të krijojnë dhe mbajnë një klimë të tolerancës në komunë.

PUBLIKIMI I FINANCAVE TË FUSHATËS DHE KUFIZIMET E SHPENZIMEVE

Rregulla e KQZ-së 2000/12 reagon në pabarazitë e financimit të partive politike, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur të vërtetuar. Rregulla kërkon që të gjitha entitetet politike të vërtetuara të publikojnë të hollat e tyre të gatshme në dorë dhe të gjitha të ardhurat. Aq më parë, çdo person që bënë pagesë më tepër se 1000 DM për entitetin e vërtetuar politik duhet të identifikohet. Publikimi i raportit të parë financiar do të nevojitet më 15 Shtator dhe do të përfshijë periudhën nga data 1 Prill 2000. Publikimi i raportit tjetër do të nevojitet tridhjetë ditë pas zgjedhjeve. Formularët e raporteve të publikuara do të mbahen nga OSBE-ja dhe do të jenë në dispozicion për shqyrtim publik.

Rregulla gjithashtu e cakton kufirin e shpenzimeve të fushatës në 1 DM për votuesin e regjistruar në secilën komunë për të cilën entiteti i vërtetuar politik do të marrë pjesë në zgjedhje. Ky kufizim mund të ngritet në rrethana të veqanta. Në mënyrë që ky kufizim të bëhet i detyrueshëm, llogaritë e hollësishme të të gjitha shpenzimeve të fushatës do të nevojiten tridhjetë ditë pas publikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Sikurse edhe me publikimin e raportit të kontributeve, ky informacion do të mbahet nga OSBE-ja dhe do të jetë në dispozicion për shqyrtim publik.

ANËTARËT E KKZ-së

Ju nuk do të keni qasje në situatën e shpenzimeve financiare të partive politike, por ju do të dini se sa votues janë regjistruar në komunën tuaj. Nëse ka disa shpenzime të tepërta që e vlejné për ta njoftuar NKZPA-në mund të plotësoni formularin e ankesës. Por duhet që të jeni i sigurtë për informatën para se të plotësoni një ankesë që ka të bëjë me shpenzimet e zgjedhjeve.

SHQYRTIMI PUBLIK I LISTËS SË VOTUESE, PERIUDHA E KONFIRMIMIT, SHTIMIT DHE SFIDAVE

Rregulla e zgjedhjeve 2000/10 e lejon personin i cili është regjistruar të votojë të verifikojë informatat votuese të tij/saj dhe informatat identifikuese personale në Listën së Përkohshme si dhe të kërkojë që ndonjë gabim të përmirësohet ose të kërkojë që emri i tij/saj të shtohet nëse rastësisht është lënë jashtë listës votuese. Aq më parë, kjo periudhë i jep mundësi votuesit dhe zyrtarëve të OSBE-së/UNMIK-ut që të sfidojë personin që është në listën votuese me arsyetim se personi nuk i përmbush kërkesat për zotësi juridike civile dhe për të votuar.

KQZ-ja gjithashtu vendosi që personi i cili është regjistruar që të votojë në mungesë për komunën ku ai ose ajo ka banuar më 1 Janar 1998 dhe kthehet përgjithmonë në atë komunë mund të parashtrijë kërkesën që të ndërrojë vendvotimin e tij ose saj gjatë periudhës së Konfirmimit, Shtimit dhe Sfidave. Në mënyrë të njëjtë personi i cili është regjistruar të votojë jashtë Kosovës por i cili është kthyer në Kosovë mund të parashtrijë kërkesën gjatë periudhës së Konfirmimit, Shtimit dhe Sfidave që të votojë në një vendvotim brenda në Kosovë. Në të dyja rastet afati i fundit për të ndërruar vendvotimin ku personi do të hedh votën e tij ose të saj do të jetë dita e fundit e periudhës së Konfirmimit, Shtimit dhe Sfidave.

MEDIAT

Qëllimi i përgjithshëm i Rregullës 2000/11 është që të nivelizojë fushëveprimin në mes të entiteteve politike duke siguruar që entitetet më të vogla me më pak mjete financiare kanë qasje të barabartë dhe të balancuar në media. Këto masa do t'iu bëjnë të mundur entiteteve politike më të vogla e me më pak mjete financiare që të garojnë me organizatat më të mëdha dhe të shprehin porositë e tyre me efikasitet.

KQZ-ja gjithashtu pajtohet që të gjitha mediat duhet të përpiqen që të sigurojnë se të gjitha partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur të vërtetuar do të kenë përfshirje të drejtë dhe të barabartë në lidhje me fushatën e zgjedhjeve gjatë procesit të zgjedhjeve.

Mediave të shtypit do t'u lejohet që të publikojnë shpalljet e paguara politike por duhet që të sigurojnë qasje të barabartë dhe parime të barabarta në caktimin e çmimeve. Çdo sasi e hapsirës së dhënë në shtyp për një entitet politik të vërtetuar duhet t'i jipet të gjitha entiteteve politike të vërtetuara brenda zonës qarkulluese të botimit. Gjithashtu organizatat që shpërndajnë mediat e shtypit siç janë kiosqet janë përgjegjëse që të sigurojnë shitjen e një zgjedhje të shumëllojshme të botimeve.

Rregulla 2000/11 i ndalon të gjitha mediat që të përfshijnë çfarëdo aktiviteti politik që ka lidhje me fushatën 24 orë para hapjes së vendvotimeve. Rregulla më tutje fton mediat që të përpiqen për të siguruar se të gjitha entitetet politike të vërtetuara të kenë përfshirje të drejtë dhe të barabartë si dhe të sigurojnë për publikun informata të sakta dhe të balansuara. Mediat nuk mund të publikojnë hulumtimin publik të mendimeve rreth zgjedhjeve prej pesë ditë para se të hapen venvotimet deri në mbylljen e tyre.

Rregulla gjithashtu u jep instruksione të gjitha transmetimeve të mediave që të sigurojnë kohën e barabartë të emetimit dhe qmimet e njejta për të gjitha entitetet e vërtetuara politike, gjatë 45 ditëve para ditës së zgjedhjeve.

Komesari i përkohshëm i mediave (apo pasardhësi i tij - Komisioni i Përkohshëm i Mediave) e ka caktuar në direktivën administrative se sa kohë për emetim u duhet ndarë entiteteve të vërtetuara politike.

ANËTARËT E KKZ-së

Në media, mënyra më e mirë për të qëndruar larg thashethënave, dhe për të qenë i sigurtë për përputhjen me udhëzimet e OSBE-së lidhur me raportet e mediave në terren, është të jeni gjithmonë të hapur, të shoqërueshëm dhe të besueshëm. Ju duhet të bashkëpunoni ngushtë me Zyrtarin e Zgjedhjeve dhe të mos komentoni jashtë komunës tuaj lidhur me situatën apo faktet tjera. Raporti i mirë me media siguron rrjedhë të shpejtë të informatave për votuesit. Si rregull të përgjithshme, ju duhet:

- Të jepni informata lidhur me vendvotimet dhe procesin e zgjedhjeve në komunë
- Të mos spekuloni lidhur me ndikimin e mirë apo të dobët të procesit nëpër Kosovë
- Të flisni rreth gjërave të veqanta të komunës tuaj. Të iu shmangeni komenteve të lajmeve nga burimet tjera në të cilat ju nuk do të kishit informatën e fundit apo direkte.

INFORMIMI I VOTUESVE

Rregulla zgjedhore 2000/6 kërkon nga të gjitha stacionet televizive publike dhe private të emetojnë pa pagesë shpalljet publike mbi regjistrimin civil dhe procesin e zgjedhjeve. Këto shpallje publike duhet të emtohen shumë herë gjatë ditës në terminet kryesore. Ato janë pjesë e fushatës për edukimin e njerëzve lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre në procesin e zgjedhjeve. Këtu përfshihen informatat si të procesit të regjistrimit ashtu edhe të votimit: çfarë dokumente kërkohen dhe ku dhe kur duhet të prezentohen.

Informimi i votuesve gjithashtu përfshinë motivimin e votuesve për tu sqaruar votuesve se pse duhet të votojnë për këshillin komunal në tetor.

Zgjedhjet demokratike duhet të jenë të lira, të drejta dhe informuese. Nëse votuesve apo disave prej tyre u janë dhënë informata të pamjaftueshme, kjo mund të ndikojë në mënyrë negative në motivimin e tyre për të votuar.

ANËTARËT E KKZ-së

Divizioni i Informimit Publik i OSBE-së e ka themeluar rrjetin e shpërndarësve të vendit në mënyrë që të sigurojnë që informtat e procesit të zgjedhjeve t'i marrin sa më shumë votues që është e mundur. Gjithashtu ata kanë punuar me grupe specifike si me gratë, rininë, dhe minoritetet përmes operacioneve të drejtpërdrejta. Të gjitha aktivitetet e informimit publik kanë për qëllim të sigurojnë informime për votuesit.

Si anëtar i KKZ-së, ju duhet që me kohë të kontaktoni me njerëzit nga Divizioni i Informimit Publik në terren dhe së bashku me ta të vlerësoni se në qfarë mënyre mund të ndihmoni dhe të merrni pjesë në ato përpjekje në mënyrë që votuesit të informohen mirë.

Duhet të mbani në mend që votuesit dhe kandidatët duhet t'i trajtoni në mënyrë të barabartë sa i përket qasjes ndaj informatës. Ata kanë të drejtë të jenë të informuar dhe ju keni obligim t'i përmbushni nevojat e tyre, duke i ndihmuar me informata me shkrim apo duke i orientuar në burime tjera.

VËZHguesIT

Vëzhguesit e zgjedhjeve luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin e paanësisë dhe kredibilitetit të procesit të zgjedhjeve si dhe në rrënjosjen e besimit në proces. Departamenti i Operacioneve të Zgjedhjeve do të sigurojë trajnim për vëzhguesit e vendit.

Siq është themeluar në Rregullën e Zgjedhjeve 2000/8, do të jenë të akredituara dy kategori të vëzhguesve për zgjedhje: vëzhguesit e vendit dhe vëzhguesit e partive politike. Të gjitha organizatat joqeveritare të vendit të cilat janë të regjistruara sipas Rregulloreve të UNMIK-ut mund të paraqiten për akreditim që të vëzhgojnë regjistrimin dhe procesin e zgjedhjeve. Si shtesë, partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur të vërtetuara mund të emërojnë përfaqësues për ta vëzhguar regjistrimin dhe procesin e zgjedhjeve. Përfaqësuesit dhe vëzhguesit duhet të jenë të akredituar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ). Të gjithë përfaqësuesit e emëruar do të jenë persona të cilët janë regjistruar për të

votuar, të cilët nuk synojnë post të zgjedhur publik dhe të cilët nuk do të pengojnë procesin e zgjedhjeve.

Asnjë vëzhgues nuk mund të jetë anëtar i Forcave Policore të Kosovës apo anëtarë i Trupave Mbrotjtëse të Kosovës . Vëzhguesit gjatë vëzhgimit të aktiviteteve të zgjedhjes do të jenë të paanshmëm dhe politikisht neutral.

Rregulla e Zgjedhjeve 2000/8 u lejon vëzhguesve qasje në të gjitha vendimet e KQZ-së. Ata do të kenë lirinë të kontaktojnë çfarëdo personi gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve dhe do të kenë qasje nëpër vendvotime, qendra të numërimit, qendra të regjistrimit, qendra për vërtetim, plotësim dhe për kërkesa, si dhe nëpër takimet e komisionit qendror komunal.

Përveç këtyre dy kategorive të vëzhguesve, do të jenë të akredituar edhe Vëzhguesit Ndërkombëtarë. Ata janë zakonisht parlamentarë apo zyrtarë të zgjedhjeve në shtetet e tyre. Tashmë dihet që Këshilli Evropian do të dërgojë mbi 100 vëzhgues dhe pritet që edhe disa vende të tjera do të autorizojnë delegacione të nivelit të lartë për të vëzhguar zgjedhjet komunale në Kosovë.

ANËTARËT E KQZ-së

Kredibiliteti i zgjedhjeve më së shumti bazohet në qartësinë e procesit. Vëzhgimi i zgjedhjeve ka për qëllim të sfidojë këtë aspekt të procesit. Si anëtarë të trupit zgjedhor të vendit, ju gjithmonë duhet të mirëpritni vëzhguesit, t'i dëgjoni interesat e tyre dhe të përgjigjeni në pyetjet e tyre në mënyrë sa më efektive që është e mundur. Nëse nuk gjeni përgjegje për të gjitha pyetjet, atëherë duhet t'i referoni ata në zyrën apo te personi i duhur.

Sidoqoftë, njësoj si edhe me gazetarët, gjithmonë duhet të jeni shumë të kujdesshmëm që të mos jepni ndonjë deklaratë personale mbi situatën politike apo lidhur me kandidatët apo partitë. Tani ju jeni pjesë e trupit administrativ për t'i udhëhequr zgjedhjet komunale në komunën tuaj dhe si të tillë nga ju pritet të jepni informata neutrale dhe të sakta lidhur me procesin.

NËN-KOMISIONI I ZGJEDHJEVE PËR PARASHTRESA DHE ANKESA

NKZPA –ja është themeluar nga Rregulla e Zgjedhjeve 2000/2. Qëllimi i NKZPA-së është t'i shqyrtojë të gjitha ankesat e shkeljes së rregullave të zgjedhjes, siq është cekur në Rregullorën e UNMIK-ut, në Procedurat Administrative, në Rregullat e Zgjedhjeve të KQZ-së dhe në Rregullat Administrative. NKZPA-ja gjithashtu do të marrë në shqyrtim parashtrësas që kanë të bëjnë me listat e votuesve.

NKZPA-ja është përgjegjës për hulumtimin dhe shqyrtimin e ankesave të cilat kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve siq është dëshmimi i akuzave për përdorim të dhunës ndaj votuesve apo kërcënimet ndaj votuesve apo partive politike, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, përdorimi e gjuhës nga ana e partive politike, apo kandidatëve të cilat do të nxisnin dhunën dhe mashtrimet si dhe shfaqja dhe përdorja e armëve apo ndonjë dhunë tjetër në çfarëdo mbledhje apo takim politik.

NKZPA-ja do të përbëhet nga një Komesar Kryesor Ndërkombëtar dhe tre Zëvendës Komesarë kosovarë. Procedurat e NKZPA-së dhe proceset e marrjes së vendimeve janë të përshkruara në Rregullën e Zgjedhjeve dhe në Rregullat e aprovuara të Procedurave.

Disa dënime/sankcione mund të zbatohen nga ana e NKZPA-së. NKZPA-ja ka autorizim për të urdhëruar masa ndihmëse përmirësuese; të urdhërojë gjoba që nuk e kalojnë shumën prej 10 000 DM, ose, me aprovimin e Kryesuesit të Misionit si Kryesues i KQZ-së, të largojë kandidatin nga lista e kandidatëve apo të përjashtojë partinë politike, koalicionin, iniciativën qytetare, apo kandidatin nga pjesëmarrja në zgjedhje.

NKZPA-ja është e autorizuar t'i dënojë entitetet e verifikuara politike për qfarëdo shkelje të Rregullës së Zgjedhjeve në media gjatë fushatës së zgjedhjeve dhe të kërkojë nga mediat që të përmirësojnë gabimet në mënyrë të drejtë dhe prominente. NKZPA-ja gjithashtu do të pranojë dhe hartojë raportet mbi çfarëdo shkelje të Rregullës së Zgjedhjeve 2000/12 mbi Publikimin e Financimit të Fushatave dhe Kufirin e Shpenzimeve.

SI TË PARASHTROHET ANKESA

Nëse votuesi i regjistruar, partia politike, apo kandidati ka ndonjë ankesë e cila ka të bëjë me procesin e zgjedhjeve, ai apo ajo mund të parashtrojë ankesë pranë NKZPA-së. Formularët zyrtarë të ankesave janë në dispozicion në çdo Zyre të Terrenit të OSBE-së apo në Qendër Rajonale.

Që ankesa të shqyrtohet duhet që:

- Të parashtrojë shkeljen e Rregullës së Zgjedhjeve të KQZ-së, të Rregullorës përkatëse të UNMIK-ut apo të Direktivave Administrative
- Të përshkruajë dhunën/incidentin në sa më shumë detaje që është e mundur
- Të dorëzohet me shkrim brenda tre ditësh prej kur ka ndodhur shkelja e supozuar, apo prej kur ankuesi është bërë i vetëdijshëm për atë shkelje, cilado që është më e vonshme
- Të nënshkruhet nga ana e ankuesit, i cili do të tregojë që sipas njohurisë së tij/saj kjo është e vërtetë.
- Të dorëzohet në zyrën qendrore të NKZPA-së apo te cilido Anëtar Ndërkombëtar i Misionit në cilëndo Qendër Rajonale apo Zyre në Terren të OSBE-së.

Vendimet përfundimtare të NKZPA-së janë publike. Sidoqoftë, dosjet dhe hetimet mbesin plotësisht sekrete.

ANËTARËT E KQZ-së

Si votues i regjistruar, cilido anëtarë i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve ka të drejtë të parashtrojë ankesë në NKZPA secilën herë kur ai/ajo të jetë i vetëdijshëm për shkeljen e Rregullave dhe Rregulloreve të Zgjedhjeve. Anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve duhet që veqanërisht të jenë të vetëdijshëm për Rregullën e Zgjedhjeve 2000/1, e cila e tregon kodin e mirësjelljes për partitë politike, koalicionet, kandidatët dhe përkrahësit e tyre.

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT (TI)

TI nuk është vetëm teknologji moderne. TI ndihmon që të sigurohet transparenca e procesit duke krijuar databaza të hapura për votuesit dhe për entitetet politike. Ky divizion nxit zvogëlimin e gabimeve njerëzore në listën e zgjedhjeve duke i bërë me të vërtetë të kuptuara. Dhe gjithashtu shërben si ndihmë për të gjitha operacionet e zgjedhjeve duke e përfshirë sigurimin e fletëvotimeve dhe materialeve, planet dhe oraret e furnizimit dhe transportit, regjistrimin e ekipit etj.

Juve do të ju dërgohen shumë lista kompjuterike dhe informata të llojeve të ndryshme. Nëse është e nevojshme ato gjithmonë do të jenë të shoqëruara me instruksione të mirëfillta, dhe do të jenë vegël e nevojshme në kryerjen e detyrave tuaja.

ZGJEDHJA E KONFLIKTIT

Në atmosferën e tendosur të fushatës së zgjedhjeve, mund të shtohen konfliktet jashtë masës dhe të zgjojnë problemin e sigurisë. Konfliktet e tilla mund të kenë lidhshmëri me vepruesit politik, ekipin punues apo rrethin. Në çdo Qendër Rajonale, ekziston Zyrja e të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit, të cilët mund të dërgojnë vëzhgues për të hulumtuar situatën, dhe për t'u munduar të gjejnë zgjidhje të drejtë për konfliktin para se të kalojë në konflikt më të gjerë. Mos ngurroni të kontaktoni Zyrën më të afërt të Terrenit apo të shkoni drejtpërdrejtë në Zyrën Rajonale.

V. SHKURTESAT

BE	Bashkësia Evropiane
CIVPOL	Policia Civile e KB-së
IP	Informimi Publik
KB	Kombet e Bashkuara
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KV	Komisionet e Vendvotimeve
NKZPA	Nën-Komisioni i Zgjedhjeve për Parashtresa dhe Ankesa
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
OMIK	OSBE Misioni në Kosovë
OSBE	Ortganizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RQ	Rajoni Qendror
TI	Teknologjia Informuese
UNHCR	Komesariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZLZ	Zyrtari i Lartë i Zgjedhjeve (në rajonin qendror)
ZT	Zyra e Terrenit
ZZ	Zyrtari i Zgjedhjeve (në zyret e terrenit)